

Simpoziumi i III-të Ndërkombëtar i Vlerësimit të Konformitetit

14-17 Maj 2012 në Stamboll të Turqisë.

U mbajt simpoziumi i III-të Ndërkombëtar i Vlerësimit të Konformitetit ku morën pjesë pjesëmarrës nga të gjitha shtetet e botës. Në takim përveç tjerash morën pjesë edhe përfaqësues të Komisionit Evropian, përfaqësues të EA-së, përfaqësues të Organeve Kombëtare të Akreditimit si edhe përfaqësues të bizneseve dhe kompanive të njohura ndërkombëtare.

Në takim u shqyrtuan shumë politika të fushës së vlerësimit të konformitetit, ku ndër të tjera u diskutua për akreditimin në shtetet tjera e Organeve Kombëtare të akreditimit si dhe përgjegjësia e Trupave të akredituara me goditje në Trupat Certifikues, politika e akreditimit jashtë kufijve shtetëror. U bisedua edhe për kërkesat e standardit ISO/IEC 17043, kërkesat për akreditimin e Ofruesve të Pt-ve dhe Notifikimi (autorizimi) i Trupave për Vlerësim të Konformitetit. Ndër të tjera në takim u shqyrtua edhe Direktiva për produktet e ndërtimtarisë (CPD) dhe ndryshimet e bëra, hartimi i Rregullores për Produktet e ndërtimtarisë (CPR) dhe hyrja në fuqi në vitin 2013.

U diskutua edhe për Etikën në Trupat Certifikuese në BSI, TURKAK dhe shtete të tjera. U morën shembuj të ndryshëm mbi funksionimin e Trupave Certifikues dhe funksionimin e tyre në degët e tyre në shtetet tjera.